



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 18/07/2022 Ref.: 956/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës (GZ. Nr.07/01 mars 2019), Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (GZ. Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018) dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 101-të, të mbajtur më 30.06.2022, mori:

V E N D I M

- I. **Riakreditohen** programet e studimit të Kolegjit Pjetër Budi, Prishtinë, për periudhën tre (3) vjeçare, duke filluar nga 1 tetor 2022 deri me 30 shtator 2025:
  1. *Doganë dhe Shpeditcion, BA*, 180 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik,
  2. *Menaxhment, MA*, 120 ECTS, *me specializim; Menaxhimi i turizmit dhe hotelierisë*, maksimumi 60 studentë për vit akademik,
- II. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Kolegji Pjetër Budi, Prishtinë që deri më datë 15.11.2022 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Kolegji Pjetër Budi, Prishtinë të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar e bartësve aprovohet nga KSHC.
- V. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë si në pikën I, mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## ARSYETIM

Kolegji Pjetër Budi, Prishtinë në afatin ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për ri akreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë;

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Doganë dhe Shpedicion, BA, 180 ECTS</i> Riakreditim	Mahije Mustafi Artan Haziri Selbije Memeti Karemani
2.	<i>Manaxhement, MA, me një specializim;</i> <i>1. Menaxhimi i turizmit dhe hotelierisë 120 ECTS</i> Riakreditim	Fitim Macani Marta Muqaj Drita Maliqi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizita me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjit Pjetër Budi në Prishtinë me këtë përbërje: Magdalena Platis, Marina Gregoric, Stefan Marius Deaconu. Vizitat janë organizuar me datë: 12.05.2022.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit dhe për secilin program, për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit *Doganë dhe Shpedicion, BA, 180 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht pesë (5) dhe pjesërisht dy (2) standarde.
- Për programin e studimit *Manaxhement, MA, me një specializim; 1. Menaxhimi i turizmit dhe hotelierisë 120 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht gjashtë (6) dhe pjesërisht një (1) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mbledhjen e 101 të mbajtur më 30.06.2022 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit Pjetër Budi, Prishtinë dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditë nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit "Pjetër Budi";
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Ass. Dr. Hasnija Iljazović  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

